

PËR

PROJEKTVENDIMIN

**“PËR TARIFAT PËR TË GJITHA VEPRIMTARITË QË ZHVILLOHEN
NË SEKTORIN E PYJEVE, MËNYRA DHE PROCEDURA E
MBLEDHJES SË TYRE”****I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i tarifave për të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në sektorin pyjor, mënyra dhe procedura e mbledhjes së tyre. Konkretisht, për tarifën e veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor, të përcaktuara në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, janë parashikuar mënyra dhe procedura e mbledhjes së këtyre tarifave.

Objektivi që synohet të arrihet është administrimi i të ardhurave të bashkisë nga përdorimi/shfrytëzimi i qëndrueshëm i fondit pyjor kombëtar, duke marrë në konsideratë se pyjet janë një burim ekonomik që sjellin zhvillim, punësim, për të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë (bujqësi, industri, energji, turizëm, argëtim, etj.), ndaj përdorimi dhe përfitimi i të mirave duhet të jetë: (i) i qëndrueshëm në raport me mundësinë; (ii) i optimizuar sipas vlerës së përdorimit; (iii) i shpërndarë në mënyrë të drejtë në raport me investimin, punën dhe riskun e marrë përsipër; (iv) duke patur si prioritet, shtresat në nevojë.

Nërkohë tarifën për veprimtaritë që zhvillohen në zonat e mbrojtura, mënyra e mbledhjes së tyre rregullohet nga ligji për zonat e mbrojtura dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME
PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË
TJERA POLITIKE**

vitin 2023, në zbatim të nenit 13, të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit.

Projektvendimi gjen mbështetje dhe është në një linjë me përcaktimet/drejtimit e dhëna nga dokumente të tjera për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, si SKZHI-ja 2020, dokument kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, si dhe VKM nr.814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030”.

Gjithashtu, projektvendimi është hartuar në përputhje me parashikimet e dokumenteve sektoriale që ndërthuren me pyjet.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Pyjet si pasuri kombëtare, kanë peshë dhe rëndësi të veçantë në zhvillimin dhe progresin e vendit, ndaj duhen pozicionuar në një linjë me politikën dhe objektivat strategjike të zhvillimit kombëtar, me kontribut të qenësishëm, duke zhvilluar sektorin nëpërmjet një sistemi të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave, strategjive, programeve, dhe planeve të mbarështimit, duke integruar dhe optimizuar interesat midis përdoruesve dhe mundësive të përdorimit/shfrytëzimit të fondit pyjor.

Propozimi i këtij vendimi synon të përfshijë në një dokument të vetëm mënyrën dhe procedurën e mbledhjes së tarifave për të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në sektorin e pyjeve, në përputhje me autorizimin ligjor sipas pikës 4 të nenit 13, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”. Gjithashtu, miratimi i këtij vendimi del si domosdoshmëri për rregullimin financiar të përfitimeve nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, përfitimeve nga prodhimi dhe shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore nga pylli, përfitimeve nga prodhimi dhe shfrytëzimi i materialit drusor, dhe ndryshimin e disa tarifave sipas çmimeve të tregut, që kanë ndryshuar ndër vite si dhe rritjen e të ardhurave për qeverisjen vendore.

Tarifat për të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në sektorin pyjor janë përcaktuar në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore

vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1156, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifatat që paguhen në zonat e mbrojtura, të masës dhe kritereve të përdorimit të tyre”, si dhe mënyra e administrimit dhe mbledhjes së tyre bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi me zonat e mbrojtura.

Për sa më sipër, vendimi i propozuar do të sjellë një administrim më të mirë të sektorit dhe fondit pyjor kombëtar, duke patur si pritshmëri për të ardhmen, mundësimin e efekteve financiare pozitive në sektor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi mbështetet në nenin 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 13, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për Pyjet” dhe vjen si propozim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe është në harmonizim me kuadrin ligjor në fuqi për pyjet dhe zonat e mbrojtura, për administrimin, mbledhjen dhe përdorimin e tarifave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti i propozuar nuk synon të përafrojë asnjë dokument të *acquis e BE-së*, pasi është akt që bazohet në legjislacionin e brendshëm të vendit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet këtij projektakti, parashikohet mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifave për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor, të përcaktuara në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, për veprimtaritë e mëposhtme:

- a) për dhënie në përdorim të fondit pyjor, sipas shtojcës nr. 1 të vendimit;
- b) për heqjen nga fondi pyjor kombëtar sipas pikës 4;

Relacion për projektvendimin “Për tarifatat për të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në sektorin e pyjeve, mënyra dhe procedura e mbledhjes së tyre”

nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jo pyjore janë sipas shtojcës nr.3

Në pikën 1, janë parashikuar tarifat sipas shtojcave, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi me përcaktimet e veprimtarive për secilën prej tyre.

Në pikën 2 dhe 3 është parashikuar mënyra dhe procedura e mbledhjes për tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor sipas shtojcës nr.1 nga bashkitë.

Në pikën 4, dhe 5 është parashikuar mënyra dhe procedura e mbledhjes për tarifat për sipërfaqet që shfrytëzohen për heqjen nga fondi pyjor kombëtar dhe çfarë ato marrin në konsideratë për llogaritjen e tyre.

Në pikën 6 është përcaktuar mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifave për kontratat sezonale të lidhura nga bashkia me subjektet.

Në pikën 7 është përcaktuar mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifave për dëmet e shkaktuara në fondin pyjor.

Në pikën 8, është parashikuar mënyra dhe procedura e mbledhjes për tarifat për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore, për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta, sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 3.

Në vijim, në pikën 9 është parashikuar mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifave kur veprimtaritë kryhen në fond pyjor privat.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektvendimi kanë kontribuar specialistët e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave dhe Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizmit të Akteve Rregullatore) si dhe është koordinuar me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve. Projektvendimi, do të dërgohet për mendim në ministritë e linjës, nëpërmjet sistemit *e-aktet*, konkretisht në Ministrinë e Drejtësisë, në Ministrinë e Brendshme dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, por do të çojë në rritje të të ardhurave për buxhetin e njësisve të vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUES

MINISTËR

Mirela KUMBARO FORXHI

